| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *Emërtimi i lëndës* | | **Studim i Faunës** | | **KODI (BIO 474)** |
| *Viti* | | I | | |
| *Semestri* | | II | | |
| *Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit* | | **Lëndë e detyrueshme: Disiplina të formimit karakterizues të programit** | | |
| *Përshkrimi* | | Kjo lënë është formuar nga bashkimi i dy moduleve: zoogjeografia dhe metoda të studimit të faunës. Moduli i parë (Zoogjeografia) ka si objekt të studiojë shpërndarjen gjeografike të gjallesave shtazore dhe të shoqërimeve të tyre në sipërfaqen e rruzullit tokësor si dhe ligjshmëritë e mekanizmat që kanë ndikuar në shpërndarjen e gjallesave shtazore. Gjithashtu, zoogjeografia merret me përshkrimin e faunës së Rajoneve të ndryshme: Holoarktik, Etiopik, Malajzian, Madagaskar, Neotropik, Polinezian, Australian, Zelandës së Re. Ajo bën rajonizimin zoogjeografik të oqeanit botëror si dhe jep disa të dhëna për faunën e Shqipërisë. Moduli i dytë (Metoda të studimit të faunës) trajton metodat dhe teknikat e studimit të faunës, duke u përqendruar me tepër në grupet kryesore shtazore. Pra, trajtohen metoda të studimit të makroinvertebrorëve, metoda të studimit të peshqëve, amfibëve, reptilëve, shpendëve dhe gjitarëve. Gjithashtu, trajtohen metodika përcaktimi për grupet e ndryshme të kafshëve nëpërmjet njohjes dhe përdorimit të çelësave të ndryshëm të faunës. | | |
| *Ngarkesa në orë* | *Në auditore* | 80 orë | | |
| | *Jashtë auditorit* | 120 orë | | |
| ***Kreditet*** | | **8 ETCS = 200 orë** | | |
| | | *Kredite (ECTS)* | *Auditor (orë)* | *Studim (orë)* |
| *Format e mësimdhënies* | *Leksione* | | | |
| | *Seminare/Laboratore* | | | |
| | ***Gjithsej*** | **8** | **80** | **120** |
| *Temat që do trajtojë lënda në formimin teorik*<br><br>42 orë leksione | | 1. Zoogjeografia, objekti i studimit dhe detyrat e saj.<br>2. Mbulesa e tokës dhe gjallesat shtazore.<br>3. Koncepti i arealit. Zhvendosja e llojit brenda arealit.<br>4. Roli i njeriut në përhapjen e kafshëve.<br>5. Endemikët, autoktonët, aborigjenët dhe emigrantët.<br>6. Llojet invazive ose të huaja (aliene).<br>7. Qendrat e prejardhjes dhe të shpërndarjes primare.<br>8. Fauna e rajoneve të izoluara, përzierja e faunave dhe fauna relikte.<br>9. Kushtet kryesore për ekzistencën e kafshëve.<br>10. Përhapja e kafshëve në kontinente. Ligjshmëritë kryesore të përhapjes së kafshëve.<br>11. Teoria e shtyrjes së relikteve dhe radiacioni adaptiv.<br>12. Teoria e ndryshimeve të kores së tokës dhe rëndësia për zoogjeografinë.<br>13. FAUNA OQEANIKE. Rajonizimi i faunës. Z<br>14. onat ekologjike të detit, rifet koralore.<br>15. Rajonet zoogjeografike të oqeanit botëror.<br>16. Rajoni i ujërave të ftohta veriore ose rajoni i Arktikut.<br>17. Rajoni i ujërave mesatare të Pacifikut Verior. Rajoni i ujërave të Atlantikut Verior.<br>18. Rajoni i ujërave të ngrohta të Indopacifikut. Rajoni i ujërave të ngrohta të Atlantikut.<br>19. Rajoni i ujërave të ftohta të Jugut ose rajoni Antarktik.<br>20. Fauna kontinentale dhe natyra e saj. Parimet e klasifikimit të faunës kontinentale.<br>21. NOTOGJEA. Rajoni i Zelandës së Re. Rajoni i Australisë. | | |

| | |
|---|---|
| | Rajoni i Polinezisë.<br>22. NEOGJEA. Rajoni i Neotropikut.<br>23. PALEOGJEA. Rajoni i Madagaskarit. Rajoni i Etiopisë.<br>24. Rajoni i Indo – Malajzisë (Lindor).<br>25. ARKTOGJEA. Rajoni i Holarktikut (Neoarktiku dhe Palearktiku).<br>26. Biomat globale.<br>27. Vlerësime për faunën shqiptare. Pamje e faunës shqiptare.<br>28. Relievi. Zonat klimatike të Shqipërisë.<br>29. Fauna e Shqipërisë dhe karakteristikat e saj.<br>30. Zoogjegrafia dhe problemet e mbrojtjes e të ruajtjes së larmisë biologjike.<br>31. Koncepti i larmisë biologjike. Detyrat parësore të strategjisë për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit.<br>32. Ekosistemet e antropogjenizuara. Njohuri për kategoritë e rrezikimit.<br>33. Mbrojtja dhe ruajtja e biodiversitetit shqiptar.<br><br><u>Moduli II (Metoda të studimit të faunës):</u><br><br>34. Metodikë përcaktimi për grupet e ndryshme të kafshëve.<br>35. Njohja dhe përdorimi i çelësave të ndryshëm të faunës.<br>36. Përcaktimi i familjeve, gjinive, specieve.<br>37. Metoda të studimit të invertebrorëve kryesor (makroinvertebrorët ujor).<br>38. Metoda të studimit të peshqëve.<br>39. Metoda të studimit të amfibëve dhe reptilëve.<br>40. Metoda të studimit të shpendëve.<br>41. Metoda të studimit të Gjitarëve.<br>42. Ushtrime praktike. |